



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladina i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports

Department of Culture
Cultural Heritage Division

DOKUMENT STRATEGJIK

PËR ORGANIZIMIN E DITËVE TË TRASHËGIMISË
EVROPIANE NË KOSOVË

STRATEGIC DOCUMENT

TO ORGANIZING EUROPEAN HERITAGE
DAYS IN KOSOVA



European Heritage Days
Journées européennes
du patrimoine





Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladina i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports

Department of Culture
Cultural Heritage Division

DOKUMENT STRATEGJIK

PËR ORGANIZIMIN E DITËVE TË TRASHËGIMISË
EVROPIANE NË KOSOVË

STRATEGIC DOCUMENT

TO ORGANIZING EUROPEAN HERITAGE
DAYS IN KOSOVA



European Heritage Days
Journées européennes
du patrimoine



CH
WB
Cultura
Heritage without Borders
KULTURARY UTAN GRANISER

PËRMBAJTJA

I. NË VEND TË HYRJES

Kultura evropiane e Kosovës	7
Pse një Dokument Strategjik për ditët e trashëgimisë?	9

II. MBI DITËT E TRASHËGIMISË EVROPIANE

Kartolina e vitit 1985	13
Kronologji e zhvillimit të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane (Historiku i shkurtër).....	13
Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian	16
Misioni i Ditëve të Trashëgimisë Evropiane.....	17
Çfarë ndodh gjatë ditëve të trashëgimisë	19
Ditët e Trashëgimisë Evropiane dhe ngritjen e vetëdijes mbi trashëgiminë kulturore.....	21

III. KOSOVA DHE DITËT E TRASHËGIMISË EVROPIANE

Trashëgimia kulturore e Kosovës pas vitit 1999	23
Gjendja e trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe debati aktual	24
Hapat e parë të ditëve të trashëgimisë në Kosovë	27
Ditët e Trashëgimisë Evropiane 2006.....	28
Ditët e Trashëgimisë Evropiane 2007	29
Mësimet e nxjerra nga organizimet e deritanishme	33

CONTENT

I. FOR INTRODUCTION

European Culture of Kosova.....	7
Why a Strategic Document for Heritage Days?	9

II. ON EUROPEAN HERITAGE DAYS

1985 Postcard.....	13
A chronology of European Heritage Days (Short history)	13
Council of Europe and European Commission	16
Mission of European Heritage Days.....	17
What happens during heritage days?	19
European Heritage Days and awareness raising on cultural heritage	21

III. KOSOVA AND EUROPEAN HERITAGE DAYS

Cultural Heritage of Kosova after 1999	23
The state of cultural heritage in Kosova and the current debate	24
First steps of heritage days in Kosova	27
European Heritage Days 2006.....	28
European Heritage Days 2007	29
Lessons learned from previous editions	33

IV. REKOMANDIMET PËR ORGANIZIMIN E DITËVE TË TRASHËGIMISË EVROPIANE NË KOSOVË

IV. RECOMMENDATIONS FOR ORGANIZING EUROPEAN HERITAGE DAYS IN KOSOVA

Kosova, pjesë e familjes evropiane të	
Ditëve të Trashëgimisë Evropiane	35
Grupet e përfshira	36
Bartësit institucional të Ditëve të	
Trashëgimisë Evropiane në Kosovë	37
Koordinatori nacional i Ditëve të	
Trashëgimisë Evropiane	38
Iniciativa dhe involvimi i grupeve	39
Dinamika kohore (Kalendari)	
e përgatitjes së Ditëve të	
Trashëgimisë Evropiane	39
Koordinimi me Këshillin e	
Evropës dhe Europa Nostra	43
Rolet e aktorëve të përfshirë	44
<i>Ministria e Kulturës, Rinisë dhe</i>	
<i>Sporteve</i>	
<i>Divizioni i Trashëgimisë Kulturore</i>	
<i>Koordinatori nacional</i>	
<i>Qeveritë lokale</i>	
<i>Shoqëria civile</i>	
<i>Donatorët</i>	
<i>Mediet</i>	
<i>Aktorët tjerë</i>	
Parime të organizimit dhe logjistikës ...	50
Financimi	50
Përzgjedhja e temave dhe	
specifikat vendore	51
Vetëdijesimi i qytetarëve për	
trashëgiminë kulturore	52
Avokimi tek vendimmarrësit	52
Listë idesh për temat që mund të	
trajtohen	53

Kosova, a member of European family	
of European Heritage Days	35
Involved stakeholders	36
Involved groups	
Institutional stakeholders of	
European Heritage Days	37
National Coordinator of European	
Heritage Days	38
Initiative and involvement	
of stakeholders	39
Time dynamics (Calendar) for	
preparing European Heritage Days	39
Coordination with Council of	
Europe and Europa Nostra	43
The roles of stakeholders	44
<i>Ministry of Culture, Youth and</i>	
<i>Sports</i>	
<i>Cultural Heritage Division</i>	
<i>National Coordinator</i>	
<i>Local governments</i>	
<i>Civil society</i>	
<i>Donors</i>	
<i>Media</i>	
<i>Other stakeholders</i>	
Principles of organization	
and logistics	50
Financing	50
Selection of topics and	
local peculiarities	51
Citizens' awareness on	
cultural heritage	52
Advocating to decision-makers	52
List of ideas for possible topics	53

V. SHEMBULL I MIRË I ORGANIZIMIT

Anglia, Britani e Madhe.....55

VI. BURIME

Institucione dhe organizata
kulturore në Kosovë59
Institucione dhe organizata
kulturore në Evropë.....61
Standarde ndërkombëtare për
trashëgiminë kulturore63

VII. FOTO KATALOGU

Fotografi të përzgjedhura nga Ditët e
Trashëgimisë Evropiane në Kosovë66
Referencat e Internetit67

V. POSITIVE CASE OF ORGANIZATION

England, Great Britain.....55

VI. SOURCES

Cultural institutions and
organizations in Kosova59
Cultural institutions and
organizations in Europe.....61
International standards of
cultural heritage63

VII. PHOTO CATALOGUE

Selected photos from European
Heritage Days in Kosova66
Internet sources67

“

*“European Heritage Days are held annually in September in 49 countries from the
altic to the Balkans, from Iceland to the Iberian Peninsular, highlighting not only
the dazzling diversity of Europe’s heritage, but also its intercultural links. As varied
as the cultural landscapes are the approaches in putting the idea into practice,,*

A quote from Heritage Open Days Website

”

I. NË VEND TË HYRJES

Kultura evropiane e Kosovës

Kultura e Kosovës është pjesë e kulturës evropiane. Kosova është pjesë e familjes së madhe kulturore evropiane. Kjo e vërtetë është e pamohueshme dhe e patjetërsueshme. Pa marrë parasysh rrethanat dhe kushtet, ndikimet dhe motivet, ky fakt është i palëkundshëm. Kosova posedon me një thesar shumë të çmueshëm kulturor, i cili e pasuron edhe më tutje kulturën evropiane. Dhe jo vetëm kaq.

Nisur nga karakteri gjithënjëzësor dhe universal i vlerave kulturore, lirisht mund të themi se pasuria kulturore e Kosovës është pasuri botërore. Ndonëse një shtet relativisht i vogël, Kosova i ofron shumë pasurisë kulturore evropiane dhe botërore. Megjithatë, tregimi nuk përfundon këtu. Në fakt, kjo është pjesa më e bukur e këtij tregimi. Pjesa tjetër lidhet me angazhimin institucional dhe qytetar për t'i ruajtur, kultivuar, promovuar dhe pasqyruar denjësisht këto vlera. Puna që kërkohet në këtë pikë është mjaft e lodhshme dhe konsumuese. Këtë gjendje e vështirëson edhe realiteti politik në të cilin po jetojmë.

Në anën tjetër, në dekadat e fundit është bërë fare pak ose aspak në drejtim të ruajtjes dhe promovimit të këtyre vlerave. E gjithë kjo situatë mjaft komplekse na obligon për veprim të menjëhershëm. Kemi humbur mjaft kohë dhe tani duhet të jemi vigjilentë dhe efektivë në veprimet tona. Urgjentisht duhet distancuar nga praktikat dëmtoese dhe neglizhenca ndaj kulturës,

I. FOR INTRODUCTION

European culture of Kosova

Culture of Kosova is part of the European culture. Kosova is a member of the big European culture family. This is an indispensable truth. Nonetheless the consequences, conditions, influences and the reasons, this is a stable fact. Kosova has a very precious cultural treasure which enriches further more the European culture. And this is not all.

Based on the human and universal character of the cultural values, we can say that the cultural values of Kosova are worldwide values. Although Kosova is a small country, it still has a lot to offer to the European and World culture. Anyway, this is not the end of the story. Actually, this is the best part of this story. The other part of it deals with the institutional and citizen involvement and commitment to conserve, cultivate and promote these values as well as to reflect them properly. There is a lot of exhausting and time-consuming work to do about this. This situation deteriorates and worsens by the political reality in which we are living.

On the other side, in the last decades it has been done a little or nothing about the conservation and promotion of these values. This complicated situation makes us constraints us for an immediate action. We have lost enough time and thus now we need to be vigilant and effective in all our actions. It is an urgent need to be put away from damaging practices and the neglect exposed to culture, by treating the culture

duke iu qasur në mënyrë strukturore, profesionale dhe me vullnet të plotë trajtimit të kulturës së vendit tonë.

Kosova ka kulturë evropiane, por më shumë se të qenit privilegj, këtë fakt në radhë të parë duhet ta pranojmë si obligim dhe nevojë për veprim efektiv. Dëshmia që duhet dhënë është kjo: Kosova jo vetëm që posedon me pasuri dhe vlera kulturore, por edhe di t'i kultivojë e të paraqitet denjësisht me ato, në krahë me vlerat tjera globale.

Burbuqe Deva-Bakija,
*Udhëheqëse e Divizionit të Trashëgimisë
Kulturore, Departamenti i Kulturës,
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit*

of our country through a structural and professional approach, as well as with a full willingness.

Kosova possesses European Culture, and this is not just a privilege but, more than that it should be accepted as an obligation and a need for an effective action. The evidence that should be given is that Kosova not only possesses cultural values but also knows how to cultivate them and be represented next to other global values.

Burbuqe Deva-Bakija,
*Head of Cultural Heritage Division, De-
partment of Culture, Ministry of Culture,
Youth and Sports*

PSE NJË DOKUMENT STRATEGJIK PËR DITËT E TRASHËGIMISË?

Një dëshmi e qartë e përkushtimit kosovar për të ecur në hap me trendët dhe zhvillimet e kulturës evropiane është edhe kremtimi i Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë në vitet 2006 dhe 2007. Gjatë këtyre dy viteve të kremtimit institucional, por edhe gjatë viteve më parë, ku organizimi ishte kryesisht i bazuar në iniciativë të shoqërisë civile, Kosova bëri një hap të rëndësishëm duke hyrë në një etapë të re të shfaqjes së kujdesit ndaj trashëgimisë së saj kulturore. Dallimi në këtë rast ishte mjaft kualitativ, ngase po kremtoheshin Ditët e Trashëgimisë Evropiane bashkë me të gjitha shtetet e Këshillit të Evropës, në një manifestim të njohur zyrtarisht nga ky institucion evropian.

Përvoja e këtyre viteve të organizimit të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë ka sugjeruar një vëmendje më të shtuar ndaj kësaj feste zyrtare të Evropës. Përgjatë këtyre pak viteve të organizimit janë nxjerrë shumë mësim, e mbi të gjitha është vërejtur nevoja imediate për një dokument strategjik, përmes të cilit do të qartësohej roli i aktorëve të involvuar dhe do të prodhohen rezultate më cilësore. I nisur si projekt i shoqërisë civile kosovare dhe i bartur nën ombrellën institucionale së voni, kremtimi i Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë kërkon një qasje më të strukturuar dhe angazhim maksimal të të gjithëve për përfaqësim të denjë të pasurisë kulturore të Kosovës. Ky Dokument Strategjik është një hap i vogël, por i domosdoshëm në këtë drejtim.

WHY A STRATEGIC DOCUMENT FOR HERITAGE DAYS?

A clear evidence of Kosovar commitment to follow the European culture trends and evolution is the celebration of European Heritage Days in Kosovo in 2006 and 2007. During these two years of institutional celebration but also during the previous years when the organization was based mainly on civil society initiative, Kosovo took an important step entering thus a new stage of showing prudence and care for its cultural heritage. The difference in this case was pretty qualitative because the European Heritage Days in Kosovo were being celebrated in parallel with all other Council of Europe states, in a manifestation officially recognized from this European institution.

The experience of organizing these European Heritage Days in Kosovo has heightened the attention to this European official holiday. Through these few years of organization have been learnt lots of lessons, and above all it has been noticed the immediate need for a strategic document which would clarify the role of the stakeholders involved, and more qualitative results would come out. The celebration of European Heritage Days in Kosovo that had started as a project of Kosovar civil society needs a more structured approach and a maximal commitment of everyone in order to have an adequate representation of the cultural values of Kosovo. This strategic document is a small step but necessary.

The content of this Strategic Document is a product of preliminary discussions be-

Përmbajtja e këtij Dokumenti Strategjik është produkt i diskutimeve paraprake mes partnerëve të projektit dhe tenton të pasqyrojë pasurinë dhe vlerat që përfaqësojnë Ditët e Trashëgimisë Evropiane, me mision të qartë, ofrimin e të gjitha informatave relevante dhe të domosdoshme për organizatorët e ditëve të trashëgimisë në Kosovë, në mënyrë që vendi unë të dëshmojë profesionalizëm dhe përshtatshmëri me standardet evropiane në organizimin e këtyre ditëve.

Pjesa hyrëse e Dokumentit Strategjik, pasohet nga një përmbledhje e informatave zyrtare mbi Ditët e Trashëgimisë Evropiane, përfshi historikun, misionin, objektivat dhe bartësit evropianë të këtij manifestimi.

Një pasqyrim i gjendjes së përgjithshme të trashëgimisë kulturore pas vitit 1999 dhe debatit aktual mbi të në Kosovë, jepet në kapitullin e radhës, ku pasqyrohen edhe **organizimet e dy viteve të fundit** të ditëve të trashëgimisë në vendin tonë.

Pjesa më vitale dhe e rëndësishme e këtij Dokumenti Strategjik, e paraqitur në formë të **rekomandimeve për organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane** në Kosovë, është përpjekje ambicioze e hartuesve të këtij Dokumenti Strategjik, me qëllim të stimulimit të kushteve për ngritjen e mëtutjeshme të cilësisë së organizimit të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë.

Pas rekomandimeve, jepet **shembulli i Anglisë**, si model i suksesshëm i organizimit dhe mundësi për të përfituar nga kjo përvojë mjaft e pasur.

tween the partners of the project and tends to reflect the values that represent European Heritage Days in Kosovo, with a clear mission that is to offer all the relevant and necessary information for the organizers of the European Heritage Days in Kosovo, so that our country can demonstrate professionalism and adaptation with the European standards for organizing these days.

The introduction of the Strategic Document follows after the summary of official information about European Heritage Days, including the history, mission, objectives and European stakeholders of this manifestation.

Next chapter presents the general situation of cultural heritage after 1999 and the current debate on this issue, which reflects also the two, last years' organization of the cultural heritage days in our country.

The most important part of this Strategic Document that is presented as a **recommendation for organizing European Heritage Days in Kosovo**, is an ambitious effort of the designers of this Strategic Document, with the purpose of stimulating the conditions for increasing further more the quality of the organization of European Heritage Days in Kosovo.

After the recommendations, is given the example of England, as a successful model of organization and as an opportunity to benefit from this rich experience.

The last part of the Strategic Document contains **resources and important information about culture itself and the cultural heritage** in Kosovo and Europe. There

Pjesa e fundit e Dokumentit Strategjik përmban **burime dhe informata të rëndësishme të sektorit të kulturës dhe trashëgimisë kulturore** në Kosovë dhe Evropë, bashkë me një listë dokumentesh më të rëndësishme ndërkombëtare, të cilat i përcaktojnë standardet e mbrojtjes, kultivimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore në Evropë dhe botë.

Ndonëse ky Dokument Strategjik është përgatitur në frymë të atillë që të jetë udhërrëfyes i shumë aktorëve të përfshirë në organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë, ai megjithatë, në radhë të parë iu dedikohet Divizionit të Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, si bartëse më e lartë institucionale (shtetërore) e organizimit të ditëve të trashëgimisë në shtetin tonë. Përgjegjësia më e lartë që nga iniciimi i organizimit e deri tek përmbyllja dhe raportimi mbi aktivitetet, i takon Divizionit të Trashëgimisë Kulturore. Prandaj, edhe ky Dokument Strategjik mëton të jetë një doracak i vyeshëm në punën e këtij institucioni, me shpresë që sado pak do t'ia lehtësoj punën dhe obligimet në këtë ndërmarrje kaq serioze dhe të rëndësishme për kulturën evropiane të Kosovës.

Natyrisht, ky është vetëm versioni i parë i këtij dokumenti, një fillim besojmë i mbarë dhe stimulues për hapa të mëtejshëm. Nuk ka fare dyshim se kjo përpjekje e parë do të ketë nevojë për pasurim gjatë viteve të ardhshme. Me këmbëngulje dhe përvojë organizimi, përmbajtja e këtij Dokumenti Strategjik do të ngritet në cilësi të dëshirueshme. Dëshirojmë, që atë nivel cilësie paralelisht ta kemi edhe në organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë.

is also a list with international important documents, which define the standards of conservation, cultivation and promotion of the cultural heritage in Europe and world-wide.

Even though this Strategic Document is prepared in such a way as to be a guideline for the stakeholders involved in organizing European Heritage Days in Kosovo, first of all it is dedicated to the Cultural Heritage Division in the Ministry of Culture, Youth and Sports, as the highest institutional stakeholder of organizing the heritage days in our country. The highest responsibility starting from the initiative for this organization up to the conclusion and reporting about activities belongs to the Cultural Heritage Division. Therefore, this Strategic Document tends to be a useful handbook for this institution hoping to make its job and the commitments easier in such a serious and important initiative for the European culture of Kosovo.

Obviously, this is just the first version of this document, hopefully a good start and stimulator for the further steps. There is no doubt that this first effort will need to be enrichment in the years to come. With insistence and experience in organizing, the content of this Strategic Document will have the desired quality. We want to have this level of quality in parallel even during the organization of European Heritage Days in Kosovo.

Hartuesit e Dokumentit Strategjik

*Divizioni për Trashëgimi Kulturore,
Departamenti i Kulturës, Ministria e
Kulturës, Rinisë dhe Sportit*

*Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij,
Suedi - Zyra në Prishtinë*

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe

Designers of the Strategic Document

*Cultural Heritage Division, Department of
Culture, Ministry of Culture, Youth and
Sports*

*Foundation Cultural Heritage without Bor-
ders, Sweden – office in Prishtina*

NGO Emancipimi Civil Ma Ndryshe



Ministria e Kulturës,
Rinisë dhe Sportit
Departamenti i Kulturës
Divizioni për Trashëgimi
Kulturore



Fondacioni
Trashëgimia Kulturore
pa Kufij,
Suedi - Zyra në Prishtinë



Organizata
Jo-Qeveritare
Emancipimi Civil Ma
Ndryshe

II. MBI DITËT E TRASHËGIMISË EVROPIANE

Kartolina e vitit 1985

"I dashur Gijs, këtu në Francë po organizohet një *La Journée Portes Ouvertes* (Ditët e Dyerve të Hapura). Po shkon mjaft mirë. Iniciativë e Jack Lang, ministër kulture i Francës. Ne e vizituam Eglise de Saint-Pierre në Comps. Mendon se edhe Holanda mund të bëj diçka të tillë?" Më 1985 këto ishin fjalët e para të një kartoline dërguar një nëpunësi të Ministrisë holandeze të kulturës, nga një koleg i vjetër, i cili u zhvendos në Francë pas pensionimit. Një shënim i shkurtër, por me ndikim të jashtëzakonshëm.

KRONOLOGJI E ZHVILLIMIT TË DITËVE TË TRASHËGIMISË EVROPIANE (HISTORIKU I SHKURTËR)

Ditët e Trashëgimisë Evropiane janë aktivitet i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Komisionit Evropian, që përfshin 49 shtetet nënshkruese të Konventës Kulturore Evropiane. Programi vjetor ofron mundësi për t'i vizituar ndërtesat, monumentet dhe objektet, shumica e të cilave zakonisht janë të mbyllura për publikun. Qëllimi i ditëve të trashëgimisë është zgjerimi i qasjes dhe stimulimi i kujdesit ndaj trashëgimisë arkitektonike dhe mjedisore. Këto aktivitete njihen edhe me emrin "Ditët e Dyerve të Hapura", karakteristikë e shteteve anglishtfolëse.

E tëra filloi në Francë më 1984, me *La Journée Portes Ouvertes*, të sponsoruar nga Ministria e Kulturës. Më 1985, në Granadë,

II. ABOUT EUROPEAN HERITAGE DAYS

Postcard of 1985

"Dear Gijs, here in France is being organized a *La Journée Portes Ouvertes* (Days of the Open Doors). It is going well. It's an initiative of Jack Lang, minister of culture in France. We visited Eglise de Saint-Pierre in Comps. Do you think Netherlands can do such a thing?" In 1985 these were the first words of a postcard sent to a clerk of the Netherlands Ministry of culture, from an old colleague, who moved to France after being retired. It is a short note but with an extraordinary influence.

CHRONOLOGY OF THE DEVELOPMENT OF EUROPEAN HERITAGE DAYS (A SHORT HISTORY)

European Heritage Days are a common activity of Council of Europe and European Commission that includes 49 states who signed the European Cultural Convention. The yearly program offer the opportunities to visit buildings and monuments, most of which are usually closed for the public. The purpose of heritage days is widening the approach and stimulating the taking of care of architectonic and environmental heritage. These activities are known as "Days of the Open Doors", that is a characteristic of English speaking countries.

It all started in 1984, with *La Journée Portes Ouvertes*, sponsored by the Ministry of Culture. In 1985, in Granada, the French Minister of culture proposed to make this activity international under the umbrella of

Ministri francez i Kulturës propozoi ndërkombëtarizimin e këtij aktiviteti nën ombrellën e Këshillit të Evropës. Holanda organizoi ditët e para të trashëgimisë *Open Monumentendag* (Ditët e Hapjes së Monumenteve) më 1987, duke u pasuar nga Suedia dhe Republika e Irlandës më 1989 dhe Belgjika e Skocia më 1990.

Në vitin 1991 këto aktivitete bashkuan nën ombrellën e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane, iniciativë e Këshillit të Evropës dhe e përkrahur nga Bashkimi Evropian. Më 1996, 40 shtete të Evropës Lindore dhe Perëndimore tashmë ishin pjesë të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane, përfshi shtetet tjera të Mbretërisë së Bashkuar, derisa më 1997 u bashkëngjiti edhe Rusia. Në vitin 2000, për herë të parë, 47 shtetet nënshkruese të Konventën Kulturore Evropiane morën pjesë në Ditët e Trashëgimisë Evropiane, me Azerbeixhanin, si anëtarin më të ri. Më 2003, numri i nënshkruesve dhe pjesëmarrësve u rrit në 49 me përfshirjen e Serbisë dhe Malit të Zi.

Ditët e Trashëgimisë Evropiane janë bartur edhe jashtë Evropës, me skema të ngjashme në Kanada, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Australi dhe vendet tjera të botës, përgjatë periudhave të ndryshme të vitit.

Sot, Ditët e Trashëgimisë Evropiane mund të konsiderohen si instrument i rëndësishëm për ofrimin e përvojave të prekshme të kulturës dhe historisë Evropiane, përveç rolit vetëdijësues mbi vlerat e shumta të trashëgimisë së përbashkët dhe nevojës së përhershme për ruajtjen e saj. Gjithandej Evropës, gjatë fundjavave të Shtatorit, Ditët

Council of Europe. Netherlands organized the first heritage days *Open Monumentendag* (Days of the opening of Monuments) in 1987, being followed by Sweden and the Republic of Ireland in 1989 and Belgium and Scotland 1990.

In 1991, these activities brought under the umbrella of European Heritage Days the initiative of the Council of Europe and supported by the European Union. In 1996, 40 states of Eastern and Western Europe were already part of European Heritage Days, including other states of the United Kingdom, while in 1997 joined also Russia. In 2000, for the first time, 47 states who had signed the European Cultural Convention took place in the European Heritage Days having with the newest member Azerbaijan. In 2003, the number of participants and the states signing this convention grew up to 49 including Serbia and Montenegro.

European Heritage Days are hold also out of Europe but with similar schemes such as in Canada, United States of America, Australia and other countries of the world, during different periods of time of the year.

Nowadays, European Heritage Days except for having the role of awareness about numerous values of common heritage and permanent need for conserving it can be considered also as a very important instrument that offers the (tangible) experiences of European culture and history. All over Europe, during weekends of September, European Heritage Days open the doors of many monuments and buildings most of which are usually closed for the public. This way they enable the citizens of Europe to enjoy and get to know their cultural her-

e Trashëgimisë Evropiane i hapin dyert e shumë monumenteve dhe objekteve, shumica e tyre zakonisht e mbyllur për publikun, duke iu mundësuar qytetarëve të Evropës shijimin dhe njohjen me trashëgiminë e tyre të përbashkët kulturore dhe duke i inkurajuar ata për të qenë aktivisht të angazhuar në ruajtjen dhe pasurimin e kësaj trashëgimie për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme. Të gjithë 49 shtetet, nënshkruese të Konventës Kulturore Evropiane aktivisht marrin pjesë në këtë iniciativë dhe numri vjetor i vizitorëve është përafërsisht 20 milionë, me mbi 30,000 monumente dhe objekte në program. Ditët e Trashëgimisë Evropiane me sukses kanë stimuluar pjesëmarrjes e shoqërisë civile, përfshirjen e rinisë, punën vullnetare dhe bashkëpunimin ndërkuftar, duke promovuar në këtë mënyrë parimet themelore të dialogut ndërkulturore, partneritetit dhe përgjegjësisë civile.

Drejtorja e Përgjithshme IV – Edukimi, Kultura dhe Trashëgimia, Rinia dhe Sporti, e Këshillit të Evropës, në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme për Edukim dhe Kulturë të Komisionit Evropian, sigurojnë drejtimin e përgjithshëm, përcaktimin dhe ekzekutimin e detyrave të përcaktuara në kornizën e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane. Sekretariati i Ditëve të Trashëgimisë Evropiane udhëhiqet nga Drejtorja për Kulturë dhe Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore e Këshillit të Evropës, nën përgjegjësinë e Komitetit Drejtues për Trashëgimi Kulturore dhe Peizazh.

Që nga lansimi i tyre në nivel Evropian, Ditët e Trashëgimisë Evropiane kanë fituar rëndësi të madhe me kalimin e viteve. Të 49

itage by encouraging them to be actively involved and committed in conserving and enriching this heritage for the existing and upcoming generations. The 49 states who signed the Cultural Convention do actively participate in this initiative and the number of visitors is approximately 20 millions per year, and there are over 30,000 buildings and monuments included in the program. European Heritage Days has successfully motivated the participation of civil society, the commitment of the youth, volunteerism and international cooperation, promoting thus, the basic principles of intercultural dialogue, partnership and civil responsibilities.

General Directorate IV – Education, culture and heritage, youth and sports, of Council of Europe in a very close cooperation with the General Directorate for education, culture and heritage, youth and sports, Council of Europe, provide the general direction. Secretariat of European Heritage Days is managed by the Directorate for Culture and Cultural and Natural Heritage of Council of Europe, under the responsibility of Steering Committee for Cultural Heritage and Landscape.

Since they reached the European level, European Heritage Days has become very important with the passing of years. The 49 states that signed the Cultural Convention are participants of these days and have demonstrated a huge success among the people. Countries that signed this Convention are: Albania, Andorra, Armenia, Austria, Azerbaijan, Byelorussia, Belgium, Bosnia and Herzegovina, Bulgaria, Croatia, Cyprus, Czech Republic, Denmark, Estonia, Finland, France, Georgia, Germany, Greece,

shtetet nënshkruese të Konventës Kulturore Evropiane të Këshillit të Evropës, janë pjesëmarrëse të këtyre Ditëve dhe kanë dëshmuar sukses të konsiderueshëm edhe në mesin e publikut. Shtetet nënshkruese të Konventës janë: Shqipëria, Andorra, Armenia, Austria, Azerbajxhani, Bjellorusia, Belgjika, Bosnjë dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republike Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Vatikani, Hungaria, Islanda, Irlanda, Italia, Letonia, Lihtenshtajni, Lituania, Luksemburgu, Malta, Moldavia, Monako, mali i Zi, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Federata Ruse, San Marino, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Maqedonia, Turqia, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar.

KËSHILLI I EVROPËS DHE KOMISIONI EVROPIAN

Një herë në vit, qytetarët e 49 shteteve e kremtojnë trashëgiminë kulturore të Evropës. Kjo iniciativë, e quajtur Ditët e Trashëgimisë Evropiane dhe e nisur nga Këshilli i Evropës më 1991, që nga viti 1999 organizohet bashkërisht nga Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian. Çdo vit në Shtator, 49 shtetet nënshkruese të Konventës Kulturore të Evropës, marrin pjesë së Ditët e Trashëgimisë Evropiane, duke i nxjerr në pah asetet e reja kulturore dhe duke i hapë objektet historike, që normalisht janë të mbyllura për publikun. Ngjarjet kulturore i zbulojnë shkathtësitë dhe traditat lokale, arkitekturën dhe veprat artistike, por qëllimi i madh mbetet afrimi dhe ndërveprimi i njerëzve në harmoni edhe përkundër dallimeve kulturore dhe gjuhësore.

Vatican, Hungary, Island, Ireland, Italy, Latvia, Lichtenstein, Lithuania, Luxemburg, Malta, Moldavia, Monaco, Montenegro, Netherlands, Norway, Poland, Portugal, Rumania, Russian Federation, San Marino, Serbia, Slovakia, Slovenia, Spain, Sweden, Switzerland, Macedonia, Turkey, Ukraine, United Kingdom.

COUNCIL OF EUROPE AND EUROPEAN COMMISSION

The citizens of the 49 states celebrate the of European heritage days once a year. This initiative, called European Heritage Days which was started by Council of Europe in 1991, has been organized with the cooperation between Council of Europe and European Commission since 1999. In September of every year the 49 states who signed the Convention, take place in the European Heritage Days, by showing out new cultural assets and by opening the doors of historical buildings that normally are closed for the people. The cultural events expose the local abilities and tradition, architecture and artistic works, but the main purpose remains the putting people together to interact in harmony opposed to cultural and linguistic differences.

Every year there are national and regional events on a certain topic. These topics differ every year depending on the country. The topics include: specific forms of heritage (ex. musical instruments, culinary tradition, and architecture), specific periods of history (ex. middle age, Baroque heritage), and society's approach to the heritage (ex. heritage and citizenship, heritage and youth). Council of Europe and European Commission always encourage the selection of the trans-na-

Çdo vit, organizohen ngjarje kombëtare dhe regjionale mbi një temë të caktuar. Këto tema ndryshojnë në varësi të vendit çdo vit. Temat përshijnë: forma specifike të trashëgimisë (p.sh. instrumente muzikore, tradita kulinare, arkitekturë), periudhe specifike të historisë (p.sh. trashëgimia mesjetare, trashëgimia e Barokut), qasja e shoqërisë ndaj trashëgimisë (p.sh. trashëgimia dhe qytetaria, trashëgimia dhe rinia). Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian gjithnjë inkurajojnë përzgjedhjen e temave trans-nacionale, të cilat mund të ilustrohen përmes aktiviteteve ndërkufitare, që organizohen bashkërisht nga shtete të ndryshme.

MISIONI I DITËVE TË TRASHËGIMISË EVROPIANE

Qëllimet kryesore të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane përfshijnë:

- Ngritjen e vetëdijes së qytetarëve Evropianë mbi pasurinë dhe shumëllojshmërinë kulturore të Evropës,
- Krijimin e një klime ku stimulohet vlerësimi për mozaikun e pasur të kulturave Evropiane,
- Luftimin e racizmit dhe ksenofobisë dhe inkurajimin e tolerancës më të madhe në Evropë dhe jashtë kufijve shtetërorë,
- Informimin e publikut dhe autoriteteve politike për nevojën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore nga kërcënimet e reja,
- Ftesën ndaj Evropës për të reaguar ndaj sfidave sociale, politike dhe ekonomike

Me qëllim të harmonizimit të të gjitha ngjarjeve kombëtare dhe regjionale dhe

tional topics, which could be illustrated through cross-border activities that are organized together with different states.

MISSION OF EUROPEAN HERITAGE DAYS

Main purposes of European Heritage Days include:

- raising the awareness of European citizens about the values and diversity of Europe,
- creating such an environment which stimulates the appreciation of the rich mosaic of European cultures,
- fighting the racism and xenophobia and also encourage a bigger tolerance in Europe and out of state borders,
- informing the people and political authorities about the need of conserving and protecting the cultural heritage from the new threats,
- inviting Europe to react toward social, political and economic challenges

In order to harmonize all the national and regional events and also their unification under the European flag, in 1991 were defined the basic principles of organizing the European Heritage Days:

- European Heritage Days must be celebrated during a September weekend,
- European Heritage Days enables the people to visit monuments and buildings all over the Europe, which are normally closed for the people,
- Buildings that are anyway opened all the tie could still contribute to the program, with the condition so that they offer special activities, such as guided visits, exhibitions, concerts, lectures,
- Visits must be for free or with a very low price,

unifikimit të tyre nën flamurin Evropian, më 1991 janë definuar edhe parimet themelore të organizimit të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane:

- Ditët e Trashëgimisë Evropiane duhet të kremtohen gjatë një fundjave të Shtatorit,
- Ditët e Trashëgimisë Evropiane iu mundëson publikut të gjerë vizitat në monumente dhe objekte nëpër gjithë Evropën, të cilat normalisht janë të mbyllura për publikun,
- Ndërtesat që janë të hapura gjatë tërë kohës, mund t'i kontribuojnë programit, me kusht që ofrojnë aktivitete speciale, siç janë vizitat me ciceronë, ekspozita, koncerte, ligjërata,
- Vizitat duhet të jenë pa pagesë, ose të ofrohen me çmim të ultë,
- Programi i Ditëve të Trashëgimisë Evropiane duhet të përmbajë organizimin e aktiviteteve specifike që do ta involvojnë publikun e gjerë dhe, në veçanti rininë dhe nxënësit,
- Të gjitha shtetet pjesëmarrëse duhet të përdorin emrin zyrtar "Ditët e Trashëgimisë Evropiane". Shtetet që e kanë nisur këtë iniciativë para vitit 1999 me një emër tjetër, duhet të përmendin se organizimi ndodh "në kornizën e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane",
- Logot e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane, Këshillit të Evropës dhe Komisionit Evropian duhet të vendosen në të gjitha materialet promovuese të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane
- Flamuri i Ditëve të Trashëgimisë Evropiane duhet të vendoset në të gjitha objektet e hapura për publik gjatë organizimit të ngjarjes.

Që nga viti 1999, Ditët e Trashëgimisë Evropiane e kanë një slogan të përhershëm:

- The program of European Heritage Days must contain specific activities where people and especially students could be involved,
- All the participating states must use the official name "European Heritage Days". States that started this initiative before 1999 with a different name, must mention that the organization is done within "the frame of European Heritage Days",
- Logos of European Heritage Days, Council of Europe and European Commission must be posted in all the promoting material for European Heritage Days,
- The flag of European Heritage must be put in all the opened buildings for the people during the events.

Since 1999, European Heritage Days have a permanent slogan: "Europe, a common heritage". This was the topic of the Council of Europe's campaign (1999-2000), upon which was decided in the Second Summit of State Heads and Governments of the states being members of the Council of Europe (Strasbourg, 1997). The campaign aimed the raise of cultural and heritage value of Europe, respecting its cultural diversity.

The interaction of Council of Europe and European Commission, in a close cooperation with the group of national coordinates, insures the success of European Heritage Days.

“Evropa, një trashëgimi e përbashkët”. Kjo ishte tema e Fushatës së Këshillit të Evropës (1999-2000), për të cilën u vendos në Samitin e Dytë të Krerëve të Shteteve dhe Qeverive të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës (Strasbourg, 1997). Fushata synonte ngritjen e vlerës së kulturës dhe trashëgimisë natyre të Evropës, duke e respektuar shumëllojshmërinë e saj kulturore.

Veprimi i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Komisionit Evropian, në bashkëpunim të ngushtë me grupin e koordinatorëve kombëtarë, siguron suksesin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane.

ÇFARË NDODH GJATË DITËVE TË TRASHËGIMISË

Çdo shtet organizon a një ditë të trashëgimisë, idealisht në fundjavën e dytë ose të tretë të Shtatorit. Çdo vit, në një shtet të ndryshëm, ndodh hapja zyrtare Evropiane. Logoja dhe motoja janë të përbashkëta: “Evropa, një trashëgimi e përbashkët”. Koordinatorët kombëtarë takohen çdo vit për t’i ndarë përvojat dhe për bashkëpunim të ardhshëm.

Dimensioni Evropian i Ditëve të Trashëgimisë Evropiane u bë i dukshëm përmes projekteve që krijuan mundësi për bashkëpunim me shtetet tjera. Për disa vite u nda një çmim special për t’i stimuluar shembujt e mirë. Disa nga këta shembujt të mirë janë:

- Aktivitetet ndërkufitare të shteteve fqinje duke krijuar turne nëpër monumente në regjione kufitare,
- Përdorimi i lidhjeve miqësore me qytetet tjera për shkëmbim

WHAT HAPPENS DURING THE HERITAGE DAYS?

Every country organizes one heritage day, the second or third week of September. The official opening happens every year in a different state. The logo and the motto are common: “Europe, a common heritage”. National coordinators meet together every year to share their experiences and look for a further cooperation.

The dimension of the European Heritage Days became so evident through the projects that created the possibility for cooperation with other countries. For several years there was given a special prize in order to stimulate the good examples. Some of these good examples are:

- cross-border activities of the neighbour countries creating thus, different tours visiting monuments in border regions,
- the use of friendly relation with other cities for exchanging information about each other’s monuments, through publications or exhibitions.

Several countries treat different topics and issues every year. The cooperation with another country which treats the same topic for comparing the monuments of each other could be an interesting idea. For example, Netherlands has exchanged the exhibitions about the parks of Lithuania and exhibitions about the wind and water mills with Greece.

Another way of treating the international dimension comes from Amersfoort, a Netherlands city. They created an inventory of different kinds of stones that are used as a construction material for histori-

informatash mbi monumentet e njëri-tjetrit, përmes publikimeve ose ekspozitave,

Disa shtete trajtojnë tema të ndryshme çdo vit. Bashkëpunimi me shtetit tjetër që e trajton të njëjtën temë për t'i krahasuar monumentet e njëri-tjetrit mund të jetë ide mjaft interesante. Për shembull, Holanda ka shkëmbyer ekspozitat mbi parqet me Lituani dhe ekspozitat mbi mullinjtë e erës dhe të ujit me Greqinë.

Një mënyrë tjetër e trajtimit të dimensionit ndërkombëtar vjen nga Amersfoort, një qytet holandez. Ata krijuan një inventar të llojeve të ndryshme të gurëve që përdoret si material ndërtimor për ndërtesa historike. Për ditën e trashëgimisë ata prodhuan një hartë që i lidhte ndërtesat dhe 20 lokacione të ndryshme nëpër tërë Evropën prej nga vinin gurët ndërtimorë.

Të gjithë shtetet e Këshillit të Evropës iu bashkuan programit të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane. Mënyra se si e tërë kjo filloi ndryshon në varësi prej shtetit. Në disa raste kremtimi filloi në një qytet ose regjion të caktuar dhe pastaj u përhap në tërë shtetin. Në vende tjera ngjarja fillimisht u organizua nga një institut privat, duke u shndërruar më vonë në ndërmarrje qeveritare, ose anasjelltas. Megjithatë, është interesante për t'u potencuar se këto formula funksionuan. Në tërë Evropën, kremtimi i këtyre ditëve atrakton mbi 20 milionë vizitorë çdo vit.

Nganjëherë ndodhin përjetime të papritura me vizitorë. Një herë në Glasgow, një Qendër trajnuese mbi Biblën, dikur një

cal buildings. For European Heritage Days they produced a map that connected the buildings and the 20 different locations through all over the Europe where the construction stones originated from.

All the countries of the Council of Europe joined the program of European Heritage Days. The way all this started, changes according to the country. In some cases the celebration started in a specific city or region and then it got spread in all over the country. In other countries the event was first organized by a private institution, which later became a governmental organization or visa versa. It is important to emphasize that these formulas worked out. The celebration of these days all over the Europe attracts more than 20 million visitors each year.

- Civil society should be more included in the organization of heritage days in Kosova,
- The lack of promoting the movable and industrial heritage of Kosova,
- Promotion of cultural heritage as a factor of socio-economic development,
- The integration of minorities through promoting the cultural heritage in the areas of minorities.

IV. REKOMANDIMET PËR ORGANIZIMIN E DITËVE TË TRASHËGIMISË EVROPIANE NË KOSOVË

Përgatitja e këtij Dokumenti Strategjik, respektivisht procesi i përcaktimit të rekomandimeve udhëzuese ka qenë i bazuar në hulumtim të gjerë, përfshi burime interneti, udhëzues, analiza dhe libra mbi përvojat e vendeve tjera dhe vetë konceptin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Evropë dhe rajon, fokus grupe për t'i nxjerrë rekomandimet dhe udhëzimet tjera të këtij Dokumenti Strategjik, intervista dhe biseda me njerëz të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore për të marrë mendimin dhe sugjerimet e tyre mbi përmbajtjen e këtij Dokumenti Strategjik. Në fund të këtij procesi, është arritur tek rekomandimet e mëposhtme, të cilat janë të vendosura në kategori të caktuara dhe përmbajnë sugjerime konkrete dhe praktike për organizim efektiv dhe të suksesshëm të ditëve të trashëgimisë.

Kosova, pjesë e familjes evropiane të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane

Si shteti më i ri në Evropë (dhe botë), Kosova duhet të veprojë urgjentisht për të qenë palë nënshkruese e Konventës Kulturore Evropiane. Ky obligim i takon Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e cila duhet t'i bashkërendojë përpjekjet me organizatat e shoqërisë civile dhe të udhëheqë një dialog intensiv me Prezencën e Këshillit të Evropës në Kosovë, për

IV. RECOMMENDATIONS TO THE ORGANIZING THE EUROPEAN HERITAGE DAYS IN KOSOVA

This strategic Document, respectively the process of designating the instructive recommendations, has been based on a wide research including internet resources, indications, analysis and books on other countries' experiences and the concept of the European Heritage Days in Europe and region, focus groups in order to come up with recommendations and other instructions of this Strategic document, interviews and other discussions with people of culture and cultural heritage in order to get their opinion and suggestions about this Strategic Document. In the end of this process, the following recommendations came out and are grouped in specific categories, containing concrete and practical suggestions for an effective and successful organization of the heritage days.

Kosova – member of European family of the European Heritage Days

As the newest state in Europe (and in the world), Kosova must act urgently to be a signing party of the Cultural Convention of Europe. This duty belongs to the Ministry of Culture, Youth and Sports, which has to coordinate and company its efforts with the civil society organizations and to lead an intensive dialogue in the presence of Council of Europe in Kosova, in order to follow correctly the procedures of signing the Con-

ndjekjen e përpiktë të procedurave të nënshkrimit të Konventën. Ndonëse Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë, gjatë viteve 2006 dhe 2007 u organizuan nën ombrellën qeveritare, mospërfshirja e Kosovës në ueb-faqen zyrtare të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane dhe në kalendarin zyrtar të këtij organizimi për këto vite, por edhe për vitin 2008, janë tregues të qartë se institucionet qeveritare të Kosovës duhet të veprojnë me urgjencë në drejtim të përfshirjes zyrtare në familjen evropiane të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane. Si hap i parë dhe i domosdoshëm rekomandohet hapja e një ueb-faqeje zyrtare të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë, ndërsa paralelisht të bëhet kërkesë institucionale për krijimin e hapësirës për ditët e trashëgimisë në Kosovë, në kuadër të ueb-faqes zyrtare të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane, e cila operon si pjesë integrale e ueb-faqes zyrtare të Këshillit të Evropës.

Grupet e përfshira

Ditët e Trashëgimisë Evropiane përqafojnë mentalitetin përfshirës evropian, përmes promovimit të shumëllojshmërisë. Kjo qasje doemos sugjeron përfshirje sa më të gjerë shoqërore në organizimin e këtyre ditëve. Të gjitha shtetet e Këshillit të Evropës tregojnë kujdes të veçantë për organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane prandaj edhe në Kosovë duhet të ketë përkujdesje të shtuar institucionale (qeveritare), duke i kushtuar rëndësi të veçantë këtyre ditëve në kalendarin vjetor kulturor të qeverisë. Përveç institucioneve qeveritare (qeveria dhe komunat), organizimi i ditëve të trashëgimisë duhet të përfshijë edhe grupet tjera shoqërore, si shoqërinë civile, bizneset, mediet, artistët e pavarur, individët tjerë të

vention. Even though, the European Heritage Days in Kosova during 2006-2007 were organized on behalf of the Government, the exclusion of Kosova in the official web-site of European Heritage Days and in the official calendar of this organization for these years, but also for 2008, are clear indicators that the Kosova Institutions must act urgently towards getting officially included in the European family of European Heritage Days. As a first step is recommended to open an official website for European Heritage Days in Kosova, while in the same time to make an institutional request for establishing the space needed for the heritage days in Kosova, under the official website of the European Heritage Days in Kosova that operates as an integral part of the official website of Council of Europe.

Involved groups

European Heritage Days embrace the mentality of Europe through the promotion of diversity. This approach suggests a wider inclusion of the society while organizing these days. All the council of Europe countries show a special treatment and care in organizing the European Heritage Days therefore, also in Kosova should be shown an increased institutional (governmental) cautiousness and carefulness, giving higher priority and importance to these days in their annual cultural calendars of the government. Except for governmental institutions (government and the municipalities), the organization heritage days should involve also other social groups such as civil society, businesses, media, independent artists, other interested individuals and other potential groups. The role of governmental institutions is very important when

interesuar dhe grupe tjera potenciale. Roli i institucioneve qeveritare është qenësor në menaxhimin e përfshirjes së gjerë shoqërore në organizimin e ditëve të trashëgimisë në Kosovë. Organizimi duhet të mbahet nën patronatin e institucioneve qeveritare (rekomandohet Ministria e Kulturës), ndërsa roli i grupeve tjera duhet të jetë qartë i definuar dhe i promovuar. Këto grupe duhet të angazhohen në cilësinë e bashkëpunëtorit, bashkorganizatorit ose bashkëfinancuesit.

Bartësit institucional të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që nga viti 2006 është bartëse zyrtare e organizimit të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë. Konkretisht, kjo përgjegjësi i takon Divizionit të Trashëgimisë Kulturore në kuadër të Departamentit të Kulturës së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Rekomandohet mbajtja e kësaj linje të përgjegjësisë dhe detyrës organizative, derisa mund të lihet e hapur mundësia e angazhimit të resorëve tjerë qeveritarë në organizimin, në varësi të tematikës së ditëve të trashëgimisë. P.sh. nëse në një vit të caktuar të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane do të trajtohet ekskluzivisht rëndësia e edukimit formal mbi trashëgiminë kulturore, atëherë bashkorganizator i Ditëve të Trashëgimisë Evropiane për atë vit mund të jetë edhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet partneritetit me nivelin komunal, varësisht nga fshati apo qyteti ku parashihet mbajtja e aktiviteteve.

managing the involvement of the society in organizing the heritage days in Kosovo. This organization should be held under the patronage of the governmental institutions (recommended the Ministry of Culture), while the role of the other groups should be well defined and promoted. These groups should be involved in the quality of a co-operating, co-organizing or co-financing.

Institutional stakeholders of European Heritage Days in Kosova

Since 2006 the Ministry of Culture, Youth and Sports, has become the official stakeholder of the organization of European Heritage Days in Kosovo. Actually, this responsibility belongs to the Cultural Heritage Division on behalf of the Department of Culture nearby the Ministry of Culture, Youth and Sports. It is recommended keeping this line of responsibility and organization tasks unless the possibility for involving other government resources is left opened, of course depending on the topics of the heritage days. For example, if in a certain year of organizing the European Heritage Days is going to be treated exclusively the importance of formal education on cultural heritage, then as a co-organizer of European Heritage Days for that year could also be the Ministry of Education, Science and Technology. A very special importance should be given to the partnership with the municipalities, depending on the village or city where as foreseen will be held the activities.

Koordinatori nacional i Ditëve të Trashëgimisë Evropiane

Një ndër nevojat më urgjente të zbuluar gjatë viteve të kaluara të organizimit të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane ishte ajo e një koordinatori që do të merrej në mënyrë permanente me sfidën e organizimit të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovës. Mungesa e një koordinatori të këtillë, ka shkaktuar vonesa në ekzekutimin e punëve dhe koordinim të dobët mes bartësit institucional dhe shoqërisë civile, por edhe në raport me Këshillit e Evropës. Për këtë arsye, rekomandohet fuqishëm, krijimi i një pozite të re pune në kuadër të Divizionit të Trashëgimisë Kulturore, për të punësuar një person i cili do të jetë përgjegjës ekskluzivisht për organizimin e ditëve të trashëgimisë në Kosovë. Në bazë të praktikës evropiane, kjo pozitë quhet Koordinator nacional i Ditëve të Trashëgimisë Evropiane. Për detalet e përshkrimit të vendit të punës së Koordinatorit nacional, mund të konsultohen termat e referencës së këtyre koordinatorëve nëpër vendet tjera evropiane. Në rast se Ministria a Kulturës, Rinisë dhe Sportit ballafaqohet me vështirësi financiare për krijimin e kësaj pozite, ajo duhet t'i hulumtojë mundësitë alternative të financimit, duke kërkuar ndihmë tek organizatat jo-qeveritare dhe fondacionet, që mund të ofrojnë ndihmë qoftë përmes resurseve humane dhe logjistike, qoftë edhe përmes sigurimit të rrogës dhe kushteve të punës për Koordinatorin nacional. Në përzgjedhjen e Koordinatorit nacional duhet të konsultohen partnerët paraprakë dhe aktualë të Divizionit të Trashëgimisë Kulturore në organizimin e ditëve të trashëgimisë në Kosovë.

The National Coordinator of European Heritage Days

One of the most urgent needs that came out during the past years of organizing the European Heritage Days was the need for a coordinator that would deal permanently with the challenge of organizing the European Heritage Days in Kosovo. The lack of such a coordinator has caused lateness in execution of works and a weak coordination between the institutional stakeholders and the civil society, but also in regard to the Council of Europe. Therefore, it is strongly recommended the creation of a new job position on behalf of the division for cultural Heritage, to hire a person who would be exclusively responsible for organizing the heritage days in Kosovo. Based on the European experience, this position is called National Coordinator of the European Heritage Days. To look for the details of this job description (National Coordinator) could be consulted the reference terms of these coordinators in other European countries. In case the Ministry of Culture, Youth and Sports faces financial difficulties for the creation of this job position, it should look for other possibilities of alternative financing to the non-governmental organizations and foundations, which could offer that help either through human and logistic resources or through providing the salary and the working conditions for the national Coordinator. When selecting the National Coordinator, there should be a consultancy between the previous and current partners of the Division for Cultural Heritage for organizing the heritage days in Kosovo.

Iniciativa dhe involvimi i grupeve

Iniciativa natyrshëm vjen nga bartësi institucional i Ditëve të Trashëgimisë Evropiane. Divizioni i Trashëgimisë Kulturore, çdo vit inicion procesin e organizimit të ditëve të trashëgimisë disa muaj ara Shtatorit, duke filluar me konsultime me grupet tjera. Procesi në nivel teknik udhëhiqet nga Koordinatori nacional i Ditëve të Trashëgimisë Evropiane. Sa më herët që fillohet me konsultimet e para, aq më shumë kohë do të ketë për organizimin e aktiviteteve gjatë ditëve të trashëgimisë. Fundi i tremujorit të parë të vitit duhet të jetë periudha në të cilën Divizioni i Trashëgimisë Kulturore, përmes Koordinatorit nacional i involvon bartësit tjerë të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane, përmes një procesi të konsultimeve dhe ndarjes së detyrave (shih Kalendarin për kohën adekuate). Kjo është periudha kur të gjithë bartësit relevantë, si organizatat jo-qeveritare, bizneset, mediet, qeveritë lokale, etj. – duhet ta kenë të qartë rolin dhe përgjegjësitë e tyre për Ditët e Trashëgimisë Evropiane në vitin përkatës.

Dinamika kohore (Kalendar) e përgatitjes së Ditëve të Trashëgimisë Evropiane

JANAR – KOORDINIMI I BRENDSHËM

Koordinatori Nacional kujdeset për përfundimin e obligimeve të mundshme nga viti i kaluar dhe në bashkëpunim me Divizionin e Trashëgimisë Kulturore siguron që kapaciteti i brendshëm institucional është në nivel të duhur për t'i filluar

The initiative and the involved groups

The initiative comes naturally from the institutional stakeholders of the European Heritage Days. The Cultural Heritage Division every year initiates the process of organization of heritage days a few months before September, starting the consulting with other groups. On the technical level, the process is guided by the national Coordinator of the European Heritage Days. The sooner the consulting start, the more time will be available for organizing the heritage days' activities. The end of the first trimester should be the period in which the Cultural Heritage Division through the national Coordinator involves the other stakeholders of European Heritage Days through out a process of consulting and defining the tasks (see the Calendar for the adequate time). This is the period when the relevant stakeholders, such as non-governmental organizations, businesses, media local governmental, etc. – should have a clear idea about their role and their responsibilities for the European Heritage Days for the specific year.

Time dynamics (Calendar) of the European Heritage Days preparation

JANUARY – INTERNAL COORDINATION

The national Coordinator takes care for the conclusion of the possible assignments from the previous year and in cooperation with the Cultural Heritage Division assures that the internal institutional capacity has the right level for starting the preparations

përgatitjet për organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në vitin respektiv. Rekomandohet edhe publikimi i broshurës me përvojat dhe mësimet e nxjerra nga viti i kaluar.

SHKURT – KONCEPTI BAZIK

Planifikimi ideor i aktiviteteve dhe përpilimi i Konceptit Bazik të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane për vitin respektiv. Divizioni i Trashëgimisë Kulturore fillon konceptimin ideor të aktiviteteve dhe përbajtjes së ditëve të trashëgimisë, duke i marrë parasysh dinamikat dhe zhvillimet aktuale në Kosovë dhe Evropë. Procesi gjithsesi duhet të jetë transparent dhe i hapur ndaj organizatave të shoqërisë civile, të cilët duhet të jenë pjesë integrale e identifikimit të temës (temave). Mund të konsiderohet edhe opsioni i shpalljes së konkursit për idenë(të) më atraktive për temat e ditëve të trashëgimisë në vitin respektiv.

MARS – PARTNERITETI DHE KOORDINIMI

Divizioni i Trashëgimisë Kulturore organizon takime me partnerët potencialë për t'i definuar aktivitetet e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane. Në këtë fazë, synohet përfshirja e sa më shumë partnerëve në procesin konsultativ. Kujdes i veçantë i kushtohet koordinimit me Zyrën Koordinuese të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane, e cila menaxhohet nga Europa Nostra, që i mbikëqyrë dhe koordinon organizimet e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në të gjitha shtetet e Evropës. Koordinatori nacional u kushton vëmendje të veçantë kalendarit të koordinimit dhe takimeve që Koordinatorët nacionalë

for organizing the European Heritage Days in the respective year. It is recommended also the publication of the leaflet with the experiences and lessons learned from the previous year.

FEBRUARY – BASIC CONCEPT

The concept for planning of the activities and the drawing of Basic Concept of the European Heritage Days for the respective year. The Cultural Heritage Division starts the conceptualization of the activities and the content of heritage days considering the dynamics and concurrencies in Kosovo and Europe. The process should be transparent and opened to the civil society organizations, which should be an integral part of the identification of the topic (topics). It could be taken into consideration also the option of announcing the competition for the most attractive ideas for the heritage day's topics in the respective year.

MARCH – PARTNERSHIP AND COORDINATION

The Cultural Heritage Division organizes meetings with potential partners to define the European Heritage Days activities. In this phase is aimed to include as much partners as possible in the process of consulting. A high attention is paid to the coordination with the Coordinating Office of European Heritage Days, which is managed by Europa Nostra that supervises and coordinates the organization of European Heritage Days in all the European countries. The national Coordinator pays a special attention to the coordination calendar and to the meetings that national coordinators take part during the year. In these

zhvillojnë gjatë vitit. Kosova duhet të jetë e përfaqësuar në këto takime të koordinimit qendror përmes Koordinatorit të saj nacional. Në këtë fazë, rekomandohet themelimi i kontakteve me shtetet e rajonit, për t'i elaboruar mundësitë e aktiviteteve të përbashkëta rajonale (ose bilaterale).

PRILL – KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

Identifikimi i audiencës dhe involvimi i publikut në përgatitje të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane. Partnerët e organizimit i konsultojnë audiencat e tyre dhe i mobilizojnë ata për pjesëmarrje në ditët e trashëgimisë. Në këtë periudhë duhet të arrihet marrëveshja për sponsorim medial të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane me një shtëpi mediale.

MAJ – FINANCIMI I AKTIVITETEVE

Definimi i përkrahjes financiare nga ana e institucioneve shtetërore, në radhë të parë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Në bazë të planit të shkruar për organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane, aplikohet për financim tek donatorët potencialë. Kujdes i posaçëm u kushtohet planifikimit të resurseve të nevojshme fizike dhe njerëzore për organizimin të suksesshëm.

QERSHOR – VULLNETARËT

Rekrutimi i vullnetarëve dhe involvimi i tyre në përgatitjen e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane. Organizatat jo-qeveritare, partnere të organizimit, marrin rol udhëheqës në kultivimin e vullnetarizmit për organizimin e ditëve të trashëgimisë.

meetings for central coordination, Kosova should be represented by its national Coordinator. In this phase, is recommended the setting up of the contacts with other regional countries, in order to elaborate the opportunities for bilateral regional activities.

APRIL – PUBLIC COMMUNICATION

Identification of the audience and the involvement of the public in the preparation of European Heritage Days. The partners of the organization consult their audiences and mobilize them to participate in the heritage days. In this period comes to an agreement for the media sponsor of European Heritage Days with a media house (company).

MAY – FINANCING THE ACTIVITIES

The definition of the financial support by the governmental institutions, and first of all from the Ministry of Culture, Youth and Sports. Based on the written plan for organizing the European Heritage Days, should be moved on to apply for financing to the potential donors. A very special attention goes to the planning of the needed resources both physical and human in order to have a successful organization.

JUNE – VOLUNTEERS

Recruiting the volunteers and involving them in the preparation of European Heritage Days. Non-governmental organizations, organizing partners, take a leading role in the cultivation of the volunteers for organizing the heritage days.

KORRIK – PROMOVIMI DHE PUBLICITETI

Mobilizimi i medieve për t'i dhënë publicitet të duhur organizimit të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane. Mediet duhet të jenë partnere të organizimit, duke e bartur përgjegjësinë më të lartë për promovimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane. Roli primar në arritjen e këtij objekti i takon sponsorit medial të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në vitin respektiv.

GUSHT – VLERËSIMET PËRFUNDIMTARE

Intensifikimi i takimeve mes partnerëve, për t'i bërë vlerësimet përfundimtare rreth aktiviteteve të planifikuara dhe identifikimi i ngecjeve eventuale për t'i evituar problemet që mund të paraqiten gjatë implementimit të aktiviteteve zyrtare në Shtator.

SHTATOR – PËRGATITJET

PËRFUNDIMTARE DHE EKZEKUTIMI

Përgatitjet për organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane duhet të vazhdojnë deri në ditët e fundit para aktiviteteve zyrtare të vitit respektiv. Shtatori është muaji zyrtar i organizimit të aktiviteteve të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane.

TETOR – VLERËSIMI DHE RAPORTIMI

Suksesi i aktiviteteve dhe ndikimi i Ditëve të Trashëgimisë Evropiane duhet të maten përmes instrumenteve të ndryshme të vlerësimit, për t'i identifikuar të metat e organizimit dhe efektshmërisë. Pason përgatitja e raporteve narrative dhe financiare mbi aktivitetet e organizuara.

JULY – PROMOTION AND PUBLICITY

Mobilization of the media to give the right publicity to the organization of European Heritage. Media should be an organizing partner, keeping the highest responsibility in promoting the European Heritage Days. The primary role in reaching this objective belongs to the media sponsor of European Heritage Days in the respective year.

AUGUST – FINAL EVALUATIONS

In this period there is an intensification of the meetings between partners in order to make the final evaluations about the planned activities and the identification of the eventual slacks in order to avoid any problems that might appear during the implementation of the official activities in September.

SEPTEMBER – FINAL PREPARATIONS AND EXECUTION

Preparations for organizing the European Heritage Days should continue till the last day before the official activities of the respective year. September is the official month of organizing the activities of European Heritage Days.

OCTOBER – EVALUATION AND REPORTING

The success of the activities and the influence the European Heritage Days have had should be evaluated through different instruments of evaluation, in order to identify the slips of the organization and effective-

NËNTOR DHE DHJETOR – KONKRETIZIMI I INICIATIVAVE

Në rast se gjatë Ditëve të Trashëgimisë Evropiane është proklamuar ndonjë iniciativë (p.sh. publikimi i një libri), atëherë dy muajt e fundit të vitit duhet punuar në drejtim të konkretizimit të këtyre iniciativave.

Koordinimi me Këshillin e Evropës dhe Europa Nostra

Detyrë e veçantë e Koordinatorit nacional të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane është koordinimi i punëve me Këshillin e Evropës, duke e përcjellë me përpikëri kalendarin zyrtar vjetor të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane dhe duke e furnizuar Këshillin e Evropës në kohë me të gjitha informatat dhe materialet e nevojshme në nivelin qendror të organizimit të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane. Në Mars të vitit 2006, pas një konkursi publik, rrjeti i organizatave Europa Nostra është përzgjedhur nga Këshilli i Evropës si Zyrë Koordinuese për Ditët e Trashëgimisë Evropiane. Europa Nostra është Federatë pan-Evropiane për Trashëgimi dhe përfshin 235 organizata jo-qeveritare që punojnë në fushën e trashëgimisë nëpër gjithë Evropën. Europa Nostra është përgjegjëse për dhënien e karakterit zyrtar Ditëve të Trashëgimisë Evropiane. Koordinatorin nacional dhe Divizioni i Trashëgimisë Kulturore duhet të punojnë në koordinim të ngushtë me Europa Nostra për të drejtën e përdorimit të simboleve të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane dhe futjen e aktiviteteve të Kosovës në kalendarin zyrtar evropian të ditëve të trashëgimisë.

ness. Further, there comes the preparation of the narrative and financial reports on the organized activities.

NOVEMBER AND DECEMBER – CONCRETIZING THE INITIATIVES

If during European Heritage Days has been proclaimed any initiative (ex. Publication of a book), then in the last two months of the year should be worked out toward concretizing these initiatives.

Coordination with the Council of Europe and Europa Nostra

A special duty of the European Heritage Days' national Coordinator is the coordination the works with the Council of Europe, following promptly the yearly official calendar of the European Heritage Days and also to provide the Council of Europe with all the needed information and material on a central level of organization of European Heritage Days. On March 2006, after a public competition took place, the Council of Europe as a Coordinating Office for European Heritage Days, selected the network of organizations Europa Nostra. Europa Nostra is a pan-European Federation for Heritage and includes 235 non-governmental organizations that work on heritage all over the Europe. Europa Nostra is responsible for giving the official character to the European Heritage Days. The National Coordinator and the Cultural Heritage Division should work on a very close cooperation with Europa Nostra for the right of using symbols in European Heritage Days and the introduction and inclusion of the Kosova activities in the official calendar of the heritage days.

Rolet e aktorëve të përfshirë

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

Divizioni i Trashëgimisë Kulturore aktualisht dhe Koordinatori nacional i Ditëve të Trashëgimisë Evropiane pasi që të krijohet si pozitë institucionale, kanë përgjegjësi ekzekutive për organizimin e ditëve të trashëgimisë. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ofron ombrellën institucionale për funksionimin e këtyre dy organeve, duke i krijuar kushte të domosdoshme pune dhe veprimi, për organizimin e ditëve të trashëgimisë. Gjithashtu, Ministria i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përmes Ministrit të saj, ka për obligim bartjen e çështjes së Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në nivel të kabinetit qeveritar, prej nga koordinohen partneritetet potenciale ndërministrorë për organizimin e aktiviteteve të ditëve të trashëgimisë. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kujdeset posaçërisht për qëndrueshmërinë financiare të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane, përmes alokimit të fondit për organizimin e këtyre ditëve, por edhe duke mobilizuar donatorë tjerë për sigurimin e mbulesës së nevojshme financiare për organizim.

• DIVIZIONI I TRASHËGIMISË KULTURORE

Detyrë primare e Divizionit për Trashëgimi Kulturore është sigurimi i vazhdimësisë së organizimit të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë, pasi që ai ka përgjegjësinë më të lartë ekzekutive për organizimin e këtyre ditëve. Divizionit të

Roles of the stakeholders

MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS

The Cultural Heritage Division and also the national Coordinator of European Heritage Days (when it becomes an institutional position), have executive responsibility for organizing the heritage days. The Ministry of Culture, Youth and Sports offers the institutional umbrella in order to have these two stakeholders functioning, by creating the necessary conditions for the work needed to organize the heritage days. The Ministry of culture, Youth and Sports is also responsible for conveying the issue of European Heritage Days to the governmental level, where get coordinated the potential inter-ministry partnerships for organizing the activities of heritage days. Ministry of Culture, Youth and Sports cares especially for the financial sustainability of European Heritage Days, through the allocation of the fund for organizing these days, but also by mobilizing other donors in order to cover all the necessary financial expenses for this organization.

• CULTURAL HERITAGE DIVISION

The principal duty of the Cultural Heritage Division is to provide the continuity of the organization of European Heritage Days in Kosovo, as it has the highest responsibility for organizing these days. The Cultural Heritage Division is highly and urgently recommended to create the position a national Coordinator for European Heritage Days on

Trashëgimisë Kulturore i rekomandohet urgjentisht themelimi i pozitës së Koordinatorit nacional të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në kuadër të skemës së tij institucionale. Koordinatori nacional do të sigurojë operacionalizim efektiv të detyrave dhe përgjegjësi të Divizionit për organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë.

• KOORDINATORI NACIONAL I DITËVE TË TRASHËGIMISË EVROPIANE

Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të Koordinatorit nacional janë të paraqitura në Kalendarin e organizimit të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë. Koordinatori nacional ka përgjegjësi operative për mbarëvajtjen e aktiviteteve të parapara në Kalendar, ndërsa ai punon nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit të Trashëgimisë Kulturore. Një ndër përgjegjësitë e rëndësishme të Koordinatorit nacional është edhe koordinimi i ngushtë me Këshillin e Evropës dhe Europa Nostra për të siguruar përputhshmërinë e organizimit të ditëve të trashëgimisë në Kosovë me kalendarin dhe organizimin zyrtar evropian të këtyre ditëve.

QEVERITË LOKALE

Qeveritë lokale duhet të jenë të përfshira drejtpërdrejtë në planifikimin dhe implementimin e aktiviteteve të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë. Divizioni i Trashëgimisë Kulturore dhe Koordinatori nacional vepronë në bashkëpunim të ngushtë me qeveritë lokale të komunave ku planifikohet organizimi i aktiviteteve të Ditëve të Trashëgimisë

behalf of its institutional scheme. The national Coordinator will provide effective operative tasks and responsibilities of the Cultural Heritage Division in Kosovo.

• NATIONAL COORDINATOR FOR EUROPEAN HERITAGE DAYS

The specific duties and responsibilities of the national Coordinator are presented in official calendar for organizing the European Heritage Days in Kosovo. The national Coordinator has an operative responsibility for the welfare and on-going of the foreseen activities in the calendar, while he works under the supervision of the Head of Cultural Heritage Division. One of the most important responsibilities of the national Coordinator is also the close coordination with the Council of Europe and Europa Nostra in order that when organizing the heritage days in Kosovo there would consistency with the calendar and European official organization of these days.

LOCAL GOVERNMENTS

Local Governments should be directly involved in planning and implementation of the activities of European Heritage Days in Kosovo. The Cultural Heritage Division and the national Coordinator act together in a very close cooperation with local governments of the municipalities where the organization of the activities of European Heritage Days is planned to be held. Local governments should be important components in organizing the heritage days, mainly and not only through Directorates for Culture. Local governments of the municipalities where the organization of heritage days' activities is being held are

Evropiane. Qeveritë lokale duhet të jenë pjesë përbërëse e përgatitjeve për ditët e trashëgimisë, kryesisht por jo vetëm, përmes Drejtorive të Kulturës. Qeveritë lokale të komunave ku vendoset organizimi i aktiviteteve të ditëve të trashëgimisë, rekomandohen fuqishëm që ta inkuadrojnë këtë çështje në agjendën prioritare të veprimtarisë qeveritare, duke u angazhuar edhe në nivel të Kryetarit të Komunës. Qeveritë lokale në Kosovë duhet paraprakisht në agjendën e tyre vjetore kulturore të planifikojnë së realizuari aktivitete të ndryshme kulturore për muajin Shtator (ekspozita, shëtitje turistike, promovime, festivale, panairë, etj.). Asociacioni i Komunave të Kosovës mund të shërbejë si partner i rëndësishëm për koordinim qendror të këtyre aktiviteteve. Qeveritë lokale duhet të kenë një rol udhëheqës edhe në mobilizimin e shkollave fillore dhe të mesme për nxitjen e veprimtarive të ndryshme kulturore dhe vetëdijesuese për trashëgiminë kulturore. Kjo do të ndikonte në kultivimin e ndjenjës së vullnetarizmit dhe masivitetin e aktiviteteve të organizuara për ditët e trashëgimisë. Një angazhim konkret në këtë drejtim paraqet edhe fushata për përfshirjen e lëndës së trashëgimisë kulturore në programin zyrtar shkollor, si lëndë obligative ose zgjedhore. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të shërbejë si partner i rëndësishëm institucional për implementimin e këtyre aktiviteteve.

SHOQËRIA CIVILE

Roli i shoqërisë civile në organizimin e ditëve të trashëgimisë u dëshmuar në inicimin e idesë dhe organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në vitet 2003, 2004

strongly recommended to give high priority to this issue by getting committed also on the Mayor level. Local governments in Kosovo should plan previously in their yearly cultural agenda the realization of different cultural activities for September (exhibitions, tourist trips, promotions, festivals, fairs, etc.). The Association of Municipalities of Kosovo could be an important partner for central coordination of these activities. Local governments should have a leading role also in mobilization of the elementary and high schools to urge them toward realizing different cultural activities and also self-awareness activities for cultural heritage. This would affect the cultivation of the volunteerism feeling and the increasing the frequency of organizing such activities for the heritage days. A concrete step to do this would be the campaign for including the subject of cultural heritage in the official school program, as a facultative or alternative course. The Ministry of Education, Science and Technology should act as an important and institutional partner for the implementation of these activities.

CIVIL SOCIETY

The role of civil society in organizing the heritage days was shown in the initiation of the idea for organizing the European Heritage Days in Kosovo in 2003, 2004 and 2005, where our country got to know the concept and the importance of such an all over Europe organization. Civil society was the one who enlightened the heritage days in Kosovo, by bringing this activity to get institutionalized and raising it to high importance in the agenda of the Ministry of culture, Youth and Sports. Non-governmental organizations and other civil society groups have a pretty big and important re-

dhe 2005 në Kosovë, kur vendi ynë u njoh me vetë konceptin dhe rëndësinë e një organizimi të këtillë mbarë-Evropian. Shoqëria civile ishte ajo që i solli ditët e trashëgimisë në Kosovë, duke ia hapur rrugën institucionalizimit të këtij aktiviteti dhe ngritjen e tij lart në agjendën e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Organizatat jo-qeveritare si dhe grupet tjera të shoqërisë civile bartin një pjesë mjaft të madhe të përgjegjësisë për suksesin dhe arritjen e objektivave të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë. Konkretisht, kjo përgjegjësi duhet t'i ketë parasysh parimet dhe detyrat në vijim:

- ofrimi i partneritetit të fortë dhe të sigurtë bartësve institucional të organizimit të ditëve të trashëgimisë, përmes ekspertizës, avokimit dhe implementimit,
- nxitja e bartësve institucional për të qenë më vigjilentë në trajtimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane,
- promovimi i frymës së bashkëpunimit dhe nxitja e partneriteteve shoqëri civile – institucione qeveritare,
- komunikimi me publikun e gjerë, duke ofruar informata relevante për rëndësinë e ditëve të trashëgimisë,
- mobilizimi i grupeve të ndryshme shoqërore për të kontribuar në promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës për Ditëve të Trashëgimisë Evropiane,
- hapja e kanaleve të bashkëpunimit me organizatat dhe rrjetet evropiane të trashëgimisë kulturore, për të përfituar nga përvoja e tyre,
- përkrahje bartësve institucional në ngritjen e fondeve për organizimin e ditëve të trashëgimisë.

sponsibility for the success and the meeting of objectives in the European Heritage Days in Kosovo. Specifically, this responsibility should consider the following principles and duties:

- Offering a strong and sincere partnership to the institutional stakeholders of the organization of heritage days, through expertise, avocation and implementation,
- Urging the institutional stakeholders to be more vigilant when dealing with the European Heritage Days,
- Promoting the cooperation and induce the partnerships between civil society and governmental institutions,
- The public communication, offering relevant information for the importance of heritage days,
- Mobilization of different social groups in order to have their contribution in promoting the cultural heritage of Kosovo for the European Heritage Days,
- Opening the channels of cooperation with European organizations and networks for cultural heritage in order to take advantage from their experiences,
- Supporting the institutional stakeholders in fund-raising for organizing the heritage days.

A very important duty of the civil society is also the recruitment of volunteers and the stimulation of volunteerism in organizing the European Heritage Days in Kosovo. Through volunteerism, the heritage days, first of all affect the enlargement of this activity, while in the same time they help in cultivating the feeling of taking care of the

Detyrë me rëndësi e veçantë e shoqërisë civile është edhe rekrutimi i vullnetarëve dhe kultivimi i vullnetarizmit në organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë. Përmes punës vullnetare, ditët e trashëgimisë në rend të parë ndikojnë në masivizimin e këtij aktiviteti, ndërsa paralelisht ndihmojnë në kultivimin e ndjenjës së kujdesit dhe të përkatësisë për vlerat e trashëgimisë kulturore të Kosovës dhe nevojën për mbrojtje dhe promovim të këtyre vlerave. Grupet e shoqërisë civile duhet të veprojnë si partnerë më të besueshëm dhe efektivë të bartësve institucional për organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë.

DONATORËT

Suksesi i ditëve të trashëgimisë është esencialisht i lidhur me pjesëmarrjen dhe kontributin e donatorëve në organizim. Oferta ndaj donatorëve të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe assesi e orientuar vetëm në sigurimin e fondeve të donatorit. Të gjithë ata që shprehin gatishmërinë për t'i përkrahur financiarisht aktivitetet e ditëve të trashëgimisë, duhet të jenë pjesë përbërëse e organizimit dhe të përfshihen në të gjitha fazat e implementimit të aktiviteteve. Donatori duhet të konceptohet si partner i rëndësishëm dhe që duhet konsultuar për idetë dhe sugjerimet përgjatë përgatitjeve për ditët e trashëgimisë. Donatorit duhet t'i ofrohet hapësirë për vendimmarrje në mënyrën e shpenzimit të fondeve të zotuarra dhe përfshirje aktive në planifikim dhe implementim të aktiviteteve të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane.

cultural heritage in Kosovo and the need for protecting and promoting these values. Civil society groups should act as the most confident and effective partners of the institutional stakeholders for organizing the European Heritage Days in Kosovo.

DONORS

